

Alban KODRA

SHPJEGIME MBI KUPTIMIN E DREJTË TË RITEVE ISLAME NË JETËN E PËRDITSHME

Diskutimi mbi disa aspekte të mënyrës së jetesës islame do të jetë më i plotë, nëse kihen parasysh parimet e përgjithshme të vizionit islam mbi botën, njeriun, pozicionin e njeriut në botë dhe kuptimin e jetës. Në këtë mënyrë do të kishim në dorë çelësin e leximit islam të realitetit dhe do të krijohej kuadri i plotë në të cilin vendosen këto aspekte.

Burimi bazë i doktrinës islame është Zbulesa Hyjnore, Kurani i Shenjtë, i cili, për çdo musliman, është edhe burimi i të gjitha normave të sjelljes, i të gjithë rregullave të jetesës. Në besimin islam, Kurani i Shenjtë është Fjala e Allahut, Krijuesit të gjithësisë, dhe jo e Muhamedit (a.s.). Aty Zoti pohon të vërtetën bazë: njëshmërinë e Tij si krijuesi i gjithçkaje që ekziston, duke përfshirë edhe njeriun. Nën këtë këndvështrim, raporti themelor në të cilin bën pjesë njeriu, është ai që e lidh me Zotin: raporti i krijimit. Në këtë raport, Allahu, si Krijues i gjithësisë, ndodhet në pozitën e sovranit, kurse njeriu, si krijesë, ndodhet në pozitën e të nënshtruarit. Sovraniteti i Allahut mbi gjithësinë është i lidhur ngushtë me pozitën e Tij si Krijues, rrjedhojë e të cilit është edhe genia e Tij Zotërues dhe Zot i gjithçkaje që ekziston. Ekzistenca e çdo gjëje zhvillohet sipas një projekti krijues hyjnor, në bazë të një tërësie ligjesh që rregullojnë gjithçka dhe nuk lënë asgjë në dorë të rastësisë. Kështu, edhe njeriu, në kuadrin më të gjerë të ekzistencës, ka marrë rregulloren e vet hyjnore, për të jetuar si njeri. Porse krijesa njeri, ndryshe nga krijesat e tjera, nuk është e prirë për nga natyra për t'u bindur. Për sa i përket bindjes ndaj rregullores hyjnore të ekzistencës tij, njeriu ka marrë prej Krijuesit dhuratën e veçantë të lirisë së zgjedhjes së sjelljes. Më pas, nga këto zgjedhje varet edhe fati i tij në jetën e përtejme.

Pozita e njeriut në gjithësi

Në Kuranin e Shenjtë përshkruhet në mënyrë të hollësishme krijimi i njeriut nga Zoti i Plotfuqishëm, duke hedhur poshtë hipotezat evolucioniste mbi origjinën e racës njerëzore, të cilat, për më tepër, nuk kanë asnjë bazë shkencore. Ashtu si çdo gjë e kësaj gjithësie ekziston për një qëllim të caktuar, edhe njeriu është krijuar për të zhvilluar një rol të caktuar në këtë botë. Ekzistenca e njeriut mbi faqe të Tokës ka filluar me vetëdijen e pasjes së një misioni dhe jo e çorientuar. Modeli i jetës, në të cilin realizohet njerëzimi i vërtetë, u është paraqitur njerëzve nëpërmjet Zbulesës Hyjnore dhe, në mënyrë shumë të qartë, atyre u është mësuar rruga që të çon drejt suksesit final. Jeta e njeriut në Tokë, e cila ka kufizimet e veta kohore, është terreni ku provohet besimi i tij. Jeta e përtejme është e amshuar dhe atje, burri dhe gruaja, të cilët janë përgjegjës për sjelljen e tyre, sipas saj do të marrin shpërblimin përkatës. Allahu i Lartmadhëruar thotë:

"Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë." (Kuran, 16: 97).

Këto janë modelet e parashtruara nga Allahu për burrat dhe gratë; kjo është pika e referimit mbi të cilën do të bazohet gjykimi final. Në këto mësimë jepet një tregues i qartë i rrugës që duhet të përshkojnë krijesat njerëzore, për të arritur suksesin në jetën e ardhshme.

Sistemimi i jetesës

Njeriu është një realitet i veçantë në tërë krijimin, sepse përbëhet nga shpirti dhe materia. Në mënyrë që njeriu të jetë vërtet njeri, duhet që të realizojë ekuilibrin midis aspektit të vet shpirtëror dhe atij material. Ky ekuilibër është qëllimi i normave që Allahu i ka caktuar njeriut. Vetëm kur zbatohen normat e kodit të jetesës islame, njeriu arrin që, nëpërmjet vendosjes së ekuilibrit midis shpirtit dhe trupit të tij, të ketë një jetë të mirë, njerëzore. Për këtë arsye, praktikat e asketizmit dhe të murgjërisë janë të huaja për kodin e jetës islame, ashtu siç janë të gabuara ato doktrina që ia mohojnë vlerën pozitive aspektit material të jetës njerëzore. Çdo botëkuptim që ndan dy elementët themelorë

të identitetit njerëzor, elementin shpirtëror dhe atë material, është një dhunim i papranueshëm që i bëhet natyrës njerëzore. Allahu i ka dhënë njeriut një vizion të plotë të jetës dhe të realitetit. Mësimet e Tij prekin çdo sferë të veprimtarisë njerëzore, shpirtërore dhe materiale, individuale dhe shoqërore, edukuese dhe kulturore, ekonomike dhe politike. Jeta e njeriut është e përbërë nga veprime dhe sjellje. Për çdo veprim e për çdo sjellje të njeriut Allahu i Madhërishëm ka përcaktuar rregulla të posaçme, me qëllim që njeriu, duke i zbatuar ato, të përmbushë qëllimin për të cilin është krijuar. Edhe për rastet e gëzimit dhe të hidhërimit që njeriu përjeton gjatë jetës së tij, Islami ka përcaktuar rregulla të posaçme. Ja disa nga normat e përditshmërisë islame që shoqërojnë njeriun nga lindja gjer në vdekje.

1- Lindja e fëmijës dhe ritualet e saj islame

Si në të gjitha bashkësitë njerëzore kudo në botë, edhe në Islam lindja e një fëmije konsiderohet si bekim, madje ajo është qëllimi kryesor i martesës. Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë: “Martohuni me gra të dashura që lindin shumë, sepse unë do të krenohem me ju para kombeve të tjera”. Kjo ngjarje shoqërohet nga një sërë rregullash, normash dhe ritesh ceremoniale, të cilat po i përmendim si më poshtë:

- **Këndimi i ezanit:** Në traditën islame është zakon që të porsalindurit t’i këndohet ezani në veshin e djathtë. Vetë Profeti (a.s.) i ka kënduar në vesh ezanin nipit të tij të porsalindur, Hasanit.¹ Kjo bëhet në mënyrë që gjëja e parë që të dëgjojë i porsalinduri në këtë botë, të jetë thirrja për të njohur dhe adhuruar Krijuesin e vet.²

- **Tahniku:** *Tahniku* është praktika e lyerjes së gojës së foshnjës me diçka të ëmbël. Shokët e Muhamedit (a.s.) i dërgonin tek ai fëmijët e porsalindur për t’ua lyer gojën me hurma arabike të përtypura.³ Në kohët e sotme është mirë që foshnja të çohet te një dijetar ose autoritet fetar që ta bëjë këtë veprim.

- **Akika dhe rruajtja e kokës:** *Akika* është ceremonia e kurbanit që theret për lindjen e fëmijës në ditën e shtatë të lindjes së tij. Kjo ceremoni është e pëlqyeshme dhe jo e detyrueshme.⁴ Kafsha e kurbanit duhet të jetë bagëti e imët. Theret një dele ose dash

për femrën dhe dy dele ose dy desh për mashkullin (nëse ka mundësi, përndryshe mjafton edhe një bagëti). Një pjesë e mishit bëhet gosti për të afërmit, shokët, komshinjtë dhe të varfrit, kurse pjesa tjetër mbahet. Po në këtë ditë, fëmijës i rruhet koka me brisk dhe vlera e argjendit që peshon sa flokët e tij, shpërndahet për bamirësi.⁵ Preferohet që rruajtja e kokës të bëhet para kurbanit, që të ndryshojë nga kurhani i haxhillëkut.

- **Vënia e emrit:** Emri mund t'i vihet fëmijës që në momentin e lindjes⁶ ose ditën e shtatë pas lindjes, së bashku me ceremoninë e *akika-s*,⁷ ose në një ditë tjetër. Duhet që emri të ketë kuptim të mirë. Preferohen emrat që tregojnë përrulje para Zotit dhe emrat e profetëve. Ndalohen të vihen emrat që i përkasin vetëm Zotit, si p.sh.: *Rahman* – i Gjithëmëshirshëm, *Rahim* – Mëshirëplotë, *Gafur* – i Gjithëfalës etj. Nuk pëlqehen të vihen emrat që kanë kuptim të keq dhe emrat e engjëjve.

- **Synetllëku:** Dijetarët muslimanë kanë mendime të ndryshme për synetllëkun. Disa e konsiderojnë të pëlqyeshëm, por jo detyrim, kurse disa të tjerë e quajnë detyrim. Sidoqoftë, synetllëku konsiderohet në Islam si një karakteristikë e natyrës së pastër njerëzore⁸ dhe traditë e profetit Ibrahim. Koha e tij nuk është e përcaktuar, por është mirë të bëhet para pubertetit,⁹ sidomos në ditën e shtatë pas lindjes së foshnjës.¹⁰ Gostia me rastin e synetllëkut është e paligjshme në Islam, sepse synetllëku është ritual fetar dhe, si i tillë, çdo gjë që i shtohet atij, është e ndaluar për sa kohë që nuk mbështetet në Kuran apo në fjalët e Profetit Muhamed (a.s.).¹¹ Por, në qoftë se synetllëku bëhet në ditën e shtatë, atëherë duhet të shtrohet gostia e *akika-s*.

2- Ceremonitë dhe ritet islame të martesës

Martesa islame është një kontratë që ka për objekt krijimin e një familjeje muslimane. Sipas Sheriatit (ligjit islam), martesa konsiderohet e detyrueshme për atë që ka mundësi financiare dhe rrezikon rënien në haram; ndërsa për atë që ka mundësi dhe nuk rrezikohet nga shthurja, martesa është e pëlqyeshme.¹² Në mënyrë që kjo kontratë të jetë e vlefshme, është e domosdoshme që secili nga kontraktuesit të jetë i aftë mendërisht për të kuptuar dhe për të pasur vullnet të lirë, si dhe të ketë arritur pjekurinë seksuale. Gjithashtu, që akti martesor të jetë i

për femrën dhe dy dele ose dy desh për mashkullin (nëse ka mundësi, përndryshe mjafton edhe një bagëti). Një pjesë e mishit bëhet gosti për të afërmit, shokët, komshinjtë dhe të varfrit, kurse pjesa tjetër mbahet. Po në këtë ditë, fëmijës i rruhet koka me brisk dhe vlera e argjendit që peshon sa flokët e tij, shpërndahet për bamirësi.⁵ Preferohet që rruajtja e kokës të bëhet para kurbanit, që të ndryshojë nga kurbanit i haxhillëkut.

- **Vënia e emrit:** Emri mund t'i vihet fëmijës që në momentin e lindjes⁶ ose ditën e shtatë pas lindjes, së bashku me ceremoninë e *akika-s*,⁷ ose në një ditë tjetër. Duhet që emri të ketë kuptim të mirë. Preferohen emrat që tregojnë përrulje para Zotit dhe emrat e profetëve. Ndalohen të vihen emrat që i përkasin vetëm Zotit, si p.sh.: *Rahman* – i Gjithëmëshirshëm, *Rahim* – Mëshirëplotë, *Gafur* – i Gjithëfalës etj. Nuk pëlqehen të vihen emrat që kanë kuptim të keq dhe emrat e engjëjve.

- **Synetllëku:** Dijetarët muslimanë kanë mendime të ndryshme për synetllëkun. Disa e konsiderojnë të pëlqyeshëm, por jo detyrim, kurse disa të tjerë e quajnë detyrim. Sidoqoftë, synetllëku konsiderohet në Islam si një karakteristikë e natyrës së pastër njerëzore⁸ dhe traditë e profetit Ibrahim. Koha e tij nuk është e përcaktuar, por është mirë të bëhet para pubertetit,⁹ sidomos në ditën e shtatë pas lindjes së foshnjës.¹⁰ Gostia me rastin e synetllëkut është e paligjshme në Islam, sepse synetllëku është ritual fetar dhe, si i tillë, çdo gjë që i shtohet atij, është e ndaluar për sa kohë që nuk mbështetet në Kuran apo në fjalët e Profetit Muhamed (a.s.).¹¹ Por, në qoftë se synetllëku bëhet në ditën e shtatë, atëherë duhet të shtrohet gostia e *akika-s*.

2- Ceremonitë dhe ritet islame të martesës

Martesa islame është një kontratë që ka për objekt krijimin e një familjeje muslimane. Sipas Sheriatit (ligjit islam), martesa konsiderohet e detyrueshme për atë që ka mundësi financiare dhe rrezikon rënien në haram; ndërsa për atë që ka mundësi dhe nuk rrezikohet nga shthurja, martesa është e pëlqyeshme.¹² Në mënyrë që kjo kontratë të jetë e vlefshme, është e domosdoshme që secili nga kontraktuesit të jetë i aftë mendërisht për të kuptuar dhe për të pasur vullnet të lirë, si dhe të ketë arritur pjekurinë seksuale. Gjithashtu, që akti martesor të jetë i

saktë ligjërisht, duhet të plotësojë këto kushte:

a - Kujdestari: Kujdestar mund të jetë babai i vajzës, një tjetër që ka marrë vajzën në kujdestari, burri më i afërt nga familja e babait, personi me më autoritet në familjen e saj, ose edhe i pari i vendit. Profeti (a.s.) ka thënë: “Nuk ka martesë, ka veçse me lejen e kujdestarit.”¹³ Kujdestari duhet të kërkojë lejen e vajzës për martesë.

b - Dy dëshmitarët: Në aktin e martesës duhet të jenë të pranishëm dy ose më shumë dëshmitarë, burra muslimanë, të njohur si të drejtë, duke u bazuar në vargun e Kuranit: “*Merrni prej jush dy dëshmitarë të drejtë*” (Talak: 2) dhe në thënien e Profetit (a.s.): “Nuk ka martesë, përveçse me lejen e kujdestarit dhe në prani të dy dëshmitarëve të drejtë.”¹⁴

c - Forma ligjore e aktit: Forma e aktit është thënia e burrit, apo e përfaqësuesit të tij në akt: *Ma jep si bashkëshorten time bijën tënde, filanen, që ke nën kujdestari!*, përgjigjja e kujdestarit: *Ta kam dhënë ty për grua bijën time, filanen* dhe thënia e burrit: *E pranoj martesën e saj me mua*.

d - Paja (mehri): Paja është dhurata që burri i jep gruas në martesë. Kjo dhuratë është detyrim, bazuar në vargun e Kuranit: **“Dhe jepuni me gjithë zemër grave tuaja dhuratën e kurorëzimit”** (Nisa: 4) dhe në thënien e Profetit (a.s.): “Gjej, qoftë edhe një unazë hekuri.”¹⁵ Është e pëlqyeshme që paja të jetë e lehtë dhe sasia e saj të përmendet në akt. Ajo mund të jepet gjatë aktit të martesës, e plotë ose pjesërisht, por edhe mund të vonohet pas aktit dhe bëhet obligim i plotë pas konsumimit të martesës. Nëse divorci ndodh para konsumimit, hiqet obligimi për gjysmën e pajës, dhe gruas i mbetet gjysma tjetër.

e - Rregulla të tjera të martesës islame:

- Predikimi (el khutba) i martesës: Para se të lidhet kontrata e martesës, personi që e lidh këtë kontratë, i cili mund të jetë një autoritet fetar ose jo, është mirë të thotë atë që quhet “predikimi i martesës” (*khutbah el-nikâh*). Aty thuhet: “Falënderimi i takon Allahut, vetëm Atij i falemi dhe vetëm Atij i kërkojmë ndihmë. I lutemi të na mbrojë nga të këqijat e vetvetes dhe të punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu, nuk ka kush ta nxjerrë nga Rruga e Drejtë, ndërsa atë që Allahu e ka shpënë në humbje, nuk ka kush ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka Zot që meriton të

adhurohet, përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij. O ju që besuat, kijeni frikë Allahun ashtu siç e meriton, dhe vdisni vetëm duke qenë besimtarë! O njerëz! Kijeni frikë Zotin tuaj, që ju ka krijuar prej një njeriu! Prej atij krijoji bashkëshorten e tij dhe prej atyre të dyve u shtuan shumë burra e gra. Kijeni frikë Allahun, me emrin e të Cilit betoheni dhe ruajeni farefisën, se Allahu është Mbikëqyrës mbi ju! O besimtarë! Kijeni frikë Allahun dhe thoni fjalë të drejta, që Ai t'ju përmirësojë veprat e t'ju falë mëkatet! Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ka arritur një fitore të madhe". Ky predikim është transmetuar nga Profeti (a.s.), i cili ka thënë: "Kush dëshiron të mbajë predikim për martesë ose për ndonjë gjë tjetër, le të thotë: Falënderimi i takon Allahut...."¹⁶

- **Gostia:** *Gosti* quhet ushqimi që përgatitet për martesë. Sipas mendimit të shumicës së dijetarëve muslimanë, ajo është detyrim për atë që ka mundësi, bazuar në një urdhër të Profetit (a.s.): "Bëj gosti, qoftë edhe me një dele."¹⁷ Ai që është ftuar në gosti, e ka obligim të marrë pjesë, se Profeti (a.s.) ka thënë: "Kushdo që ftohet në dasmë, duhet t'i përgjigjet ftesës."¹⁸ Lejohet të mos merret pjesë në gosti, nëse atje ka diçka të ndaluar.¹⁹ Kush ftohet nga dy vetë, shkon tek ai që e ka ftuar i pari. Në gosti ftohen të varfrit njëjloj si të pasurit, në bazë të thënies së Profetit (a.s.): "Ushqimi më i keq është ushqimi i asaj gostie, e cila i privohet atij që vjen dhe në të cilën thirret ai që e refuzon."²⁰ Nëse dikush ftohet kur është agjërueshëm, le t'i përgjigjet ftesës, e më pas: nëse dëshiron mund të hajë (kur është agjërimit vullnetar), e nëse jo, lutet për të zotin e dasmës dhe largohet. Profeti (a.s.) ka thënë: "Nëse dikush ftohet, le t'i përgjigjet ftesës! Nëse është agjërueshëm, të bëjë dua e nëse jo, le të hajë."²¹

- **Njoftimi i martesës me dajre dhe këngë të lejuara,** sepse Profeti (a.s.) ka thënë: "Dallimi mes hallallit dhe haramit (për sa i përket bashkimit burrë-grua) është dajrja dhe zëri."²²

- **Lutja për të sapomartuarit.** Profeti (a.s.) i thoshte atij që martohej: "Allahu të dhëntë begati dhe ju bashkoftë të dyve në mirësi."²³

- **Para kontaktit të parë seksual,** burri të vërë dorën e tij mbi ballin e bashkëshortes dhe të thotë: "O Allah! Unë të kërkoj Ty mirësinë e saj dhe mirësinë me të cilën e ke gatuar, si dhe kërkoj

mbrojtjen Tënde prej së keqes së saj dhe së keqes me të cilën e ke gatuar".²⁴

- **Para çdo marrëdhënieje tjetër seksuale**, bashkëshorti të lutet: "O Allah, largoje shejtanin prej meje dhe prej asaj që do të na japësh (fëmijës)." Sipas Profetit (a.s.), nëse burri thotë këtë lutje dhe Allahu u jep atyre fëmijë, atij fëmije shejtani nuk do t'i bëjë kurrë dëm.²⁵

Sipas Sheriatit një muslimani nuk i lejohet të martohet me gratë e mëposhtme:

- Nënë, bijat, motrat, gjyshet, hallat dhe tezet e tij;
- bijat e vëllezërve dhe bijat e motrave;
- gratë (mëndesha) që i kanë dhënë gji, si dhe vajzat e motrat e tyre;
- nënën e gruas, gruan e babait dhe gruan e të birit;
- vajzën e gruas (të cilën ajo e ka nga një martesë e mëparshme), nëse me atë grua ka pasur marrëdhënie, përndryshe kjo martesë s'është e ndaluar;
- një grua që s'është as muslimane, as e krishterë dhe as çifute për nga besimi;
- me një grua, të cilën e ka ndarë tri herë (nëse ajo pas kësaj nuk është martuar me burrë tjetër dhe pastaj të jetë ndarë prej tij);
- me një grua që është në gjendjen e *ihram*-it (duke kryer haxhillëkun);
- me motrën, tezen dhe hallën e gruas, për sa kohë që është i martuar me atë grua.

Kurse një gruaje muslimane nuk i lejohet të martohet me burrat e mëposhtëm:

- babai, vëllezërit, xhaxhai, daja dhe i biri;
- bijtë e vëllait dhe bijtë e motrës;
- babai dhe gjyshi i burrit;
- xhaxhallarët dhe dajallarët e babait dhe të nënës;
- burrin e të bijës, burrin e nënës dhe burrin e motrës (për sa kohë ai është i martuar me të motrën);
- një burrë që është në gjendjen e *ihram*-it, gjatë haxhillëkut;
- një burrë jomusliman.

3- Ceremonitë dhe rregullat islame të vdekjes

Sipas botëkuptimit islam, vdekja është stacioni i parë i jetës

së amshuar. Për këtë arsye, ajo nuk shihet si një pikë mbarimi, por si një periudhë e pashmangshme transiti për në jetën tjetër. Nisur nga ky këndvështrim, një musliman nuk e konsideron vdekjen si diçka fatale, e cila i jep fund gjithçkaje, por si një ngjarje madhore, për të cilën njeriu duhet të përgatitet, në mënyrë që çfarë vjen pas saj, të jetë më e lehtë. Një ngjarjeje të tillë Islami i ka kushtuar kujdes të veçantë, duke përcaktuar një sërë rregullash dhe normash, të cilat do t'i përmendim më poshtë:

- **Talkini i të vdekurit:** *Talkin* do të thotë t'i diktosh atij që është në prag të vdekjes thënien e dëshmisë së monoteizmit islam "la ilahe il-lAllah" – nuk ka zot që meriton të adhurohet, përveç Allahut. Cilido që është i pranishëm në çastet e fundit të jetës së dikujt, duhet t'i diktojë atij këtë shprehje, derisa i sëmuri ta thotë vetë. Kjo bëhet sipas një porosie të Profetit (a.s.), i cili ka thënë: "U diktoni atyre që janë duke vdekur fjalën *La ilahe il-lAllah*."²⁶ Ai që thotë fjalët e fundit të jetës së tij *La ilahe il-lAllah*, futet në Parajsë".²⁷

- **Drejtimi i personit, që është në prag të vdekjes, nga Qabeja:** Personi që është në prag të vdekjes, duhet kthyer në drejtim të Qabesë, mbështetur në krahun e tij të djathtë. Nëse kjo nuk është e mundur, ai duhet të qëndrojë i shtrirë me këmbët nga Qabeja.

- **Leximi i sures "Jâsîn":** Muslimanit që ndodhet në agoninë e vdekjes, i lexohet surja "Jâsîn", me shpresën që Zoti t'ia lehtësojë dhimbjet me bekimin e kësaj sureje. Profeti (a.s.) ka thënë: "Lexojeni suren Jasin për ata që janë duke vdekur!"²⁸

- **Mbyllja e syve dhe mbulimi i të vdekurit:** Mbasi njeriu jep shpirt, atij i mbyllen sytë dhe i mbulohet fytyra me një shami. Në prani të xhenazes duhen thënë vetëm fjalë të mira për të, si p.sh., "O Zot, fale! O Zot, mëshiroje!" Një herë, Profeti (a.s.) hyri te një njeri në prag të vdekjes dhe, sapo ai vdiq, Profeti ia mbylli sytë e tha: "Kur del shpirti, atë e shoqëron shikimi".²⁹ Kur njerëzit e familjes së të vdekurit filluan të bërtisnin e të klithnin, Profeti (a.s.), u tha: "Lutuni për veten tuaj, vetëm me gjëra të mira. Engjëjt bëjnë amin për ato që ju thonin".³⁰

- **Njoftimi për vdekjen:** Është mirë që për vdekjen e një personi të njoftohen të afërmit dhe shokët e tij, si dhe njerëzit e

mirë të atij vendi për të marrë pjesë në faljen e xhenazes së tij. Por ndalohej të bëhet njoftimi në rrugë apo nëpër dyert e xhamive me zë të lartë a duke bërtitur.

- **Ndalimi i vajtimit me zë dhe lejimi i të qarit:** Është e ndaluar që të vajtohet e të bërtitet për të vdekurin. Profeti (a.s.) ka thënë: "I vdekuri dënohet nga kuja e të gjallëve".³¹ Ai u merrte fjalën grave se ato nuk do të bërtisnin dhe thoshte: "Unë distancohem nga ato që klithin dhe bërtasin me zë të lartë".³² Për sa i përket të qarit të zakonshëm, pa zë, nuk përbën ndonjë problem.

- **Ndalohet të mbahet zi më tepër se tre ditë:** Ndalohet që një muslimane të mbajë zi më tepër se tre ditë, përveçse kur i vdes burri i saj. Në këtë rast ajo ka për detyrë të mbajë zi katër muaj dhe dhjetë ditë. Profeti (a.s.), ka thënë: "Gruaja nuk mban zi për të vdekurin më shumë se tre ditë, përveçse për burrin e saj, për të cilin ajo mban zi katër muaj e dhjetë ditë".³³

- **Shlyerja e borxheve të të vdekurit:** Nëse i vdekuri ka pasur borxhe, ato duhen shlyer sa më parë. Profeti (a.s.) ndalonte që të falej namazi i xhenazes për personin që kishte borxh, derisa ai të shlyhej. Për këtë ai ka thënë: "Shpirti i besimtarit është i lidhur me borxhin e tij, deri sa dikush ta shlyejë për të".³⁴

- **Lutja dhe durimi i familjes:** Është detyrë për familjarët e të vdekurit të jenë të durueshëm në këto momente të vështira e të bëjnë sa më shumë lutje. Profeti (a.s.) ka thënë: "Atij njeriu, që kur i bie ndonjë fatkeqësi, thotë: "Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehem. O Zot ! Më shpërble mua në fatkeqësinë time. Ma paso atë me diçka më të mirë". Allahu i Madhëruar ka për ta shpërblyer në fatkeqësinë e tij dhe ka për t'ia zëvendësuar me diçka tjetër më të mirë".³⁵

- **Larja e të vdekurit:** Është detyrë që personi i vdekur të lahet, i madh a i vogël qoftë. Nëse hidhet ujë mbi trupin e të vdekurit dhe ai i përfshin të gjitha pjesët e trupit, kjo është e mjaftueshme, mirëpo mënyra më e mirë do të ishte si vijon: I vdekuri vendoset në një vend të lartë. Në fillim i shtypet lehtë barku, për të nxjerrë diçka që mund të ketë mbetur nga jashtëqitja. Më pas, me dorë të mbështjellë me copë, i pastrohen mirë pjesët intime. Nëse larësi nuk është burri ose gruaja e personit të vdekur, ai nuk duhet t'i shohë pjesët e turpshme. Pastaj hiqen nga duart copat dhe i

vdekuri lahet në mënyrë të pjesshme, si abdesi që merret për t'u falur. Kështu i lahet i gjithë trupi tri herë, duke filluar nga koka deri te këmbët. Nëse nuk është pastruar mirë, i vdekuri mund lahet deri në pesë herë, duke përdorur herët e fundit sapun apo diçka të ngjashme me të. Nëse personi i vdekur është grua, i zgjidhen gërshetat dhe lahet e më pas i lidhen prapë. Kështu urdhëroi Profeti (a.s.) të bënëin me vajzën e tij të vdekur.³⁶ Më pas i vdekuri lyhet me ndonjë erë të mirë. Ai që lan të vdekurin, duhet të jetë njeri i mirë dhe besnik. Profeti (a.s.) ka thënë: **“Të vdekurit tuaj duhet të lahen nga ata që janë të besueshëm”**.³⁷

Nëse nuk ka ujë për të larë të vdekurin, ose ka vdekur një burrë dhe s'ka tjetër veçse gra apo e kundërta, ka vdekur një grua dhe ka vetëm burra, në këtë rast i vdekuri pastrohet me *tejemum* – një pastrim ritual që bëhet me dhe.³⁸ Lejohet që burri të lajë gruan e tij dhe gruaja të lajë burrin e saj. Po ashtu lejohet që gruaja të lajë djemtë e vegjël 6 vjeç e poshtë, ndërsa për sa u përket burrave, dijetarët janë të mendimit që ata të mos i lajnë vajzat, sado të vogla qofshin.

- **Mbështjellja me qefin:** Pasi i vdekuri lahet, është detyrë që ai të mbështillet me qefin dhe të mbulohen të gjitha pjesët e trupit të tij.³⁹ Pëlqehet që qefini të jetë i bardhë dhe i pastër, i ri qoftë apo i vjetër. Profeti (a.s.) ka thënë: “Vishni rroba të bardha, se ato janë nga rrobat më të mira dhe mbështillni me to të vdekurit tuaj”.⁴⁰ Gjithashtu, është e pëlqyeshme që qefini të parfumohet me tym aloeje (një lloj druri aromatik).⁴¹ Duhet tri copa për të mbështjellë burrin dhe 5 copa për të mbështjellë gruan. Është e ndaluar që i vdekuri të qefinoset me një rrobë prej mëndafshi. Mëndafshi është i ndaluar për ta veshur burrat e, po ashtu, edhe të qefinosen me të. Për sa i përket gruas, ajo e ka të lejuar ta veshë atë, ndërsa për t'u qefinosur me të nuk është e pëlqyer, sepse Profeti e ka ndaluar shpenzimin e tepërt, duke thënë: “Mos e teproni kur qefinosni, se do të vidhet shpejt”.⁴²

- **Namazi i xhenazes:** Namazi i xhenazes është detyrim kolektiv për bashkësinë e muslimanëve, ashtu si larja, qefinosja dhe varrosja e të vdekurit. Nëse falet një grup prej besimtarëve, bie detyra nga të tjerët. Profeti (a.s.) ua falte xhenazen muslimanëve. Edhe kur vdiste ndonjë musliman që kishte lënë

borxhe, megjithëse ai vetë nuk falej, u thoshte të tjerëve: “**Faljani namazin shokut tuaj!**”.⁴³ Xhenazja vendoset në drejtim të Qabesë, ndërsa imami me njerëzit qëndrojnë pas saj në tre ose më shumë rreshta, sepse Profeti (a.s.) ka thënë: “**Kujt i falet xhenazja me tre reshta, e ka hak Parajsën**”.⁴⁴ Për të falur namazin e xhenazes, duhen plotësuar kushtet e çdo namazi tjetër. Në fillim ngrihen duart deri te veshët, duke thënë “Allahu ekber”. Pastaj duart ulen, si në faljen e zakonshme dhe lexohet surja “El-Fâtiha”. Më pas thuhet sërish “Allahu ekber” dhe lexohen lutje për Profetin (a.s.). Pastaj thuhet “Allahu ekber” për herë të tretë dhe thuhet lutje për të vdekurin. Më pas thuhet “Allahu ekber” për herë të katërt dhe thuhet lutje të përgjithshme për të vdekurin dhe të gjithë muslimanët ose jepet direkt selam pa zë.⁴⁵ Nëse dikush varroset dhe nuk i është falur xhenazja, lejohet që t’i falet më vonë.⁴⁶ Po ashtu, xhenazja falet edhe në mungesë, sado e largët të jetë distanca. Profeti fali xhenazen e Negusit të Abisnisë, ndërkohë që vetë ndodhej në Medinë.⁴⁷

- **Shoqërimi i xhenazes:** Është mirë që xhenazja të shoqërohet deri në varreza, në mënyrë që njerëzit të përkujtojnë vdekjen.⁴⁸ Preferohet që bartja e xhenazes të bëhet me nxitim. Profeti (a.s.) ka thënë: “Nxitoni sepse, nëse xhenazja është e mirë, ajo që ju po bëni është një punë e mirë dhe, nëse xhenazja nuk është e mirë, ajo që ju mbani në qafat tuaja, është diçka e keqe”.⁴⁹ Pëlqehet, gjithashtu, të ecet para xhenazes.⁵⁰

- **Çfarë nuk duhet gjatë shoqërimit të xhenazes:** Nuk është mirë që gratë të shoqërojnë xhenazen për në varreza.⁵¹ Gjithashtu, urrëhet që të ngrihet zëri në prani të xhenazes, qoftë me përmendje të Allahut, lexim a diçka tjetër.⁵² Nuk pëlqehet ulja në një vend para se të vendoset xhenazja nga ata që mbajnë në tokë.⁵³

- **Varrosja:** Varrosja ka disa rregulla, prej të cilave po përmendim: a) Varri thellohet që egërsirat e shpendët të mos arrijnë te kufoma dhe që të bllokohet era e saj;⁵⁴ b) Hapja e krahut të djathtë të gropës (që quhet *lahd*) është më mirë, megjithëse është e lejuar që të hapet edhe në mes të saj. Profeti (a.s.) ka thënë: “*Lahdi* është për ne, ndërsa hapja e gropës në mes të varrit është për të tjerët”;⁵⁵ c) Pëlqehet për atë që merr pjesë në varrim,

të hedhë tre grushte me dhé në varr në pjesën e kokës së të vdekurit, siç ka vepruar Profeti (a.s.); d) I vdekuri futet në pjesën e fundit të varrit dhe drejtohet nga Qabeja, mbështetur në anën e djathtë. Pastaj i hiqen lidhjet e qefinit dhe ai që e vendos në varr, thotë: "Me emrin e Allahut, qoftë në fenë e të dërguarit të Allahut!"⁵⁶; e) Varri i gruas mbulohet me një rrobë gjatë vendosjes së saj në gropë.

- **Lutja dhe kërkimi i faljes nga Zoti për të vdekurin:** Pëlqehet për atë që merr pjesë në varrim t'i kërkojë falje Zotit për të vdekurin dhe të lutet për të, që ai të jetë i qëndrueshëm. Profeti (a.s.): "I kërkoni falje Zotit për vëllanë tuaj dhe lutuni që ai të jetë i qëndrueshëm, se ai tani po pyetet".⁵⁷

- **Varri duhet të ngrihet pak ose të jetë rrafsh me tokën:** Varri duhet të jetë rrafsh me tokën. Profeti (a.s.) ka urdhëruar që varret të jenë rrafsh me tokën, megjithëse po të ngrihen një pëllëmbë nga toka në formë barku është e lejueshme dhe shumica e dijetarëve e pëlqejnë një gjë të tillë, sepse ashtu ka qenë dhe varri i Profetit (a.s.). Nuk ka problem, nëse vendoset ndonjë shenjë te varri për t'u dalluar, siç është ndonjë gur apo diçka tjetër e ngjashme me të.

- **Ndalohet që varri të shtrohet me llaç dhe të ndërtohet mbi të:** Ndalohet që varri të shtrohet me llaç dhe të ndërtohet mbi të. Transmetohet nga Muslimi se Profeti (a.s.) e ka ndaluar një gjë të tillë.

- **Nuk pëlqehet ulja mbi varre:** Nuk pëlqehet që dikush të ulet mbi varrin e një tjetri ose ta shkelë atë me këmbë. Profeti (a.s.) ka thënë: "Mos u ulni mbi varreza dhe mos u falni në to!"⁵⁸ "Është më mirë për njeriun të ulet mbi zjarr e t'i digjen rrobat dhe lëkura e tij, sesa të ulet⁵⁹ mbi varr".⁶⁰

- **Ndalohet ndërtimi i xhamive sipër varreve:** Është e ndaluar të ndërtohen xhami sipër varreve apo të vendosen çati mbi to. Profeti (a.s.) ka thënë: "Allahu i ka mallkuar gratë që vizitojnë varret dhe ata që i bëjnë ato si xhami dhe vendosin qirinj në to".⁶¹

- **Ndalohet zhvarrosja dhe transferimi i kufomës:** Është e ndaluar zhvarrosja dhe transferimi i kufomës, përveçse në raste të domosdoshme, siç është varrosja e tij pa u larë. Po ashtu, urrehet që të zhvendoset kufoma e pavarrosur ende nga një

vend në një vend tjetër, vetëm atëherë kur vendi i transferimit është Meka, Medina ose Jerusalemi në Palestinë (tri vendet e shenjta).

- **Ngushëllimi:** Preferohet që familja e të vdekurit të ngushëllohet, burra qofshin apo gra, para varrimit deri në tri ditë pas tij. Nëse njëri prej familjes nuk ndodhet për momentin ose është larg, atëherë ngushëllimi mund të bëhet edhe më vonë. Ngushëllimi mund të bëhet me çdo fjalë. Profeti (a.s.) i ka çuar dikujt një letër ngushëllimi me këto fjalë: "E Allahut është ajo që mori, e Allahut është ajo që ka dhënë dhe çdo gjëje Allahu ia ka përcaktuar afatin, prandaj duro dhe shpreso për shpërblimin e Allahut!".⁶²

- **Risitë (bidatet) e morteve:** Një nga shumë gjëra që janë shpikur nga injoranca e njerëzve, është grumbullimi i tyre në shtëpi për ngushëllim në dreka e darka dhe shpenzimi i parave kot për mburrje dhe krenari. Muslimanët e parë nuk mblidheshin nëpër shtëpi në të tilla raste. Ata e ngushëllonin njëri-tjetrin në varreza ose kur takoheshin në çdo vend. Megjithatë, nuk ka problem, nëse njeriu shkon për ngushëllim në shtëpinë e të vdekurit, me kusht që grumbullimi të mos jetë i përgatitur qëllimisht.

- **Përgatitja e ushqimit për familjen e të vdekurit:** Pëlqehet të përgatitet ushqim për familjen e të vdekurit. Këtë e bëjnë të afërmit dhe komshinjtë ditën e vdekjes. Profeti (a.s.) ka thënë: "Përgatitni ushqim për familjen e Xhaferrit, se ata janë të preokupuar me atë që i ka gjetur!"⁶³ Për sa i përket familjes së të vdekurit, ata nuk duhet të përgatisin ushqim për të tjerët dhe kjo është e urryer, sepse atyre u shtohet fatkeqësia. Nëse në varrim merr pjesë ndonjë që është larg dhe është detyrë që të pritët, në këtë rast pëlqehet që fqinjët dhe të afërmit ta presin mysafirin në vend të familjes së të vdekurit.

- **Lëmosha për shpirtin e të vdekurit:** Pëlqehet që të jepet lëmoshë për shpirtin e të vdekurit.⁶⁴

- **Leximi i Kuranit për të vdekurin:** Nuk ka problem, nëse një musliman ulet në xhami apo shtëpinë e tij dhe lexon Kuran e, kur mbaron, i lutet Zotit për ta falur dhe mëshiruar të vdekurin nëpërmjet atij leximi. Për sa i përket grumbullimit të lexuesve të Kuranit në shtëpinë e të vdekurit, të cilët lexojnë me qëllim për

t'ia dhuruar shpërblimin e leximit të vdekurit dhe paguhen për këtë nga ana e familjes së të vdekurit, ky është bidat i papranuar që duhet braktisur. Kjo ceremoni nuk është pjesë e fesë.

- **Vizita në varreza:** Vizita në varreza është e pëlqyer, sepse ajo të kujton botën tjetër dhe vlen për të vdekurin lutja dhe kërkimi i faljes për të. Profeti (a.s.) ka thënë: "Më parë ju kisha ndaluar t'i vizitoni varrezat. Vizitojini ato, sepse ju kujtojnë ahiretin".⁶⁵ Vizitori i varrezave të muslimanëve thotë: "Paqja qoftë mbi ju, o banorët e këtyre shtëpive, që jeni besimtarë dhe muslimanë! Edhe ne, nëse do Allahu, do të vijmë te ju. Ju na kaluat dhe ne po ju ndjekim. Lusim Allahun të na falë ne dhe ju! O Zot! Fali ata! O Zot! Mëshiroji ata!".⁶⁶ Dijetarët janë të mendimit se ndalohet shkuarja e shpeshtë e grave për të vizituar varrezat.

4- Ceremonitë festive islame: Bajramet

Dy bajramet, Fitër-Bajrami dhe Kurban-Bajrami, janë festat e përvitshme të muslimanëve. Ato fillojnë me ceremonitë e faljeve kolektive një gjysmë ore pas lindjes së diellit dhe vijojnë më pas me veprimtari të tjera, një pjesë e të cilave është e ndryshme për popuj të ndryshëm. Namazet e Bajramit janë detyrim. Profeti (a.s.) u ka kushtuar tepër rëndësi këtyre namazeve dhe ka urdhëruar që në ta të dalin edhe gratë e fëmijët, sepse ceremoni të tilla janë simbole të fesë sonë dhe fenomene që të shtojnë besimin dhe devotshmërinë.

- Disa nga rregullat bajrameve:

1- Larja e trupit, lyerja me erë të mirë dhe veshja e rrobave më të bukura. Profeti (a.s.) i urdhëronte shokët e tij, që në namazet e bajrameve të vishnin rrobat më të bukura, të lyheshin me erërat më të mira dhe të thernin kurbane të shtrenjta.⁶⁷ Vetë Profeti në bajrame vishte një rrobë të madhe si pelerinë.⁶⁸

2- Ngrënia e diçkaje para daljes në namazin e Fitër-Bajramit dhe ngrënia nga mëlçitë e kurbanit pas namazit ditën e festës së Kurban-Bajramit. Profeti nuk dilte ditën e Fitër-Bajramit para se të hante diçka dhe nuk hante ditën e Kurban-Bajramit, derisa të kthehej dhe të hante nga mishi i kurbanit të tij.⁶⁹

3- Përsëritja e thirrjes "Allahu ekber, Allahu ekber, la ilahe il-lallah, Allahu ekber, Allahu ekber ue lil-lahil hamd", duke

filluar që nga netët e dy festave. Për Kurban-Bajramin kjo thirrje vazhdon deri në pasditen e ditës së katërt, ndërsa për Fitër-Bajramin, deri sa të dalë imami për të falur namazin.

4- Shkuarja në vendin e faljes nga një rrugë dhe kthimi nga një rrugë tjetër. Profeti (a.s.) e ndryshonte rrugën ditët e festave.⁷⁰

5- Falja në vend të hapur, përveç rastit kur bie shi dhe nuk është kohë e mirë (atëherë Bajrami falet në xhami). Profeti (a.s.) i ka falur këto namaze në shkretëtirë të hapur.

6- Urimi me njëri-tjetrin, duke thënë: **“Allahu ta pranoftë ty dhe mua!”**.⁷¹

7- Moskursimi në të ngrënë, të pirë dhe në dëfrimin e lejuar gjatë ditëve të Kurban-Bajramit. Profeti thotë: **“Ditët e Kurban-Bajramit (teshrikut) janë për të ngrënë, për të pirë dhe për të kujtuar Allahun e Madhëruar”**.⁷² Po ashtu, Enesi ka thënë: “Dy ditë në Medine shokët e Profetit (a.s.) luajtën dhe u zbavitën. Profeti (a.s.) u tha atyre se Allahu i ka zëvendësuar këto dy ditë me dy të tjera akoma më të mira: Fitër-Bajramin dhe Kurban-Bajramin.⁷³ Gjithashtu, Profeti (a.s.) i ka thënë një shokut të vet: **“Çdo popull ka festën e vet. Sot është dita e festës sonë”**.⁷⁴

5- Ceremoni dhe besëtytni që gabimisht konsiderohen si pjesë e Islamit

- **Mevludi:** Mevludi është ceremoni festive që bëhet për nder të ditëlindjes së Profetit Muhamed (a.s.). Duke qenë se as Profeti (a.s.), as shokët e tij nuk e festonin ditëlindjen e tij, atëherë kjo ceremoni është një risi në fe. Doktrina islame është e plotësuar, për sa i përket anës së botëkuptimit dhe të ceremonive fetare, prandaj ajo nuk pranon shtesa dhe prurje të reja në këtë aspekt. Si rrjedhojë, çdo festim ditëlindjeje nuk është pjesë e traditës islame, prandaj nuk lejohet. Vetë Profeti (a.s.) i ka kufizuar festat islame në festat e bajrameve me thënien e tij: **“Çdo popull ka festën e vet. Sot është dita e festës sonë”**. Gjithashtu, edhe mevludet që zhvillohen për të vdekurit apo për ndonjë rast tjetër, nuk janë të lejueshme.

- **Netët e mira:** I njëjti arsyetim, si edhe më sipër, përdoret për të vlerësuar çdo lloj feste tjetër që ka hyrë rishtazi në Islam. Të tilla janë të gjitha ato ceremoni që zhvillohen për netët e mira.

Në radhë të parë, ceremoni të tilla nuk bazohen në një traditë

të mirëfilltë të Profetit (a.s.). Në radhë të dytë, ato janë përzier me elementë të traditës vendase pagane ose të krishterë. Kështu, mund të përmendim se për net të mira apo bajrame, njerëzit ndezin qirinj për të vdekurit apo bëjnë hallvë, elementë këta që nuk janë pjesë e një tradite festive islame, por i përkasin traditës së trashëguar pagane apo të krishterë vendase.

- **Therja e kurbaneve për të hyrë në një shtëpi të re:** Kjo ceremoni nuk është islame, sepse, në Islam, kurbanit theret vetëm në tri raste: për festën e Kurban-Bajramit; për ceremoninë e *akikas* (një javë pas lindjes së fëmijës) dhe për të shlyer disa shkelje që bëjnë haxhilerët gjatë haxhillëkut. Therja e kurbanit në themelet e një shtëpie është një ceremoni e lashtë pagane, që nuk pranohet nga Islami, sepse nuk sjell kurrfarë dobie konkrete për shtëpinë. Ndërsa kurbanet e ligjëruara nga Islami, kanë më tepër funksion social, pasi shërbejnë për t'u ardhur në ndihmë shtresave të varfra të shoqërisë.

- **Hajmalitë dhe nuskat:** Mbajtja e hajmalive dhe nuskave është e ndaluar. Nuk lejohet kurrsesi që një musliman të mbajë hajmali. Profeti (a.s.) ka thënë: "Kush mban hajmali, ka kryer idhujtari".⁷⁵ Po ashtu ka thënë: "Kush mban hajmali, Allahu mos ia bëftë mbarë; kush var një guaskë deti (për të pasur siguri), Allahu mos e marrtë nën sigurinë e Tij!".⁷⁶ Një herë, kur Profeti (a.s.) pa dikë që mbante hajmali, i tha atij: "Mjerë për ty! Ç'e ke këtë?!" Burri iu përgjigj se e kishte vendosur ngaqë ishte i dobët. – "Hiqe", – i tha Profeti, – "se ajo nuk të shton ty veçse dobësi e, nëse vdes me të të varur, nuk ke për të shpëtuar kurrë".⁷⁷ Praktikën e hajmalive dhe nuskave Islami e ka zëvendësuar me praktikën e lutjes dhe mjekimit. Kështu, Profeti (a.s.) kurohej dhe i kuronte të tjerët me anë të lutjeve ose leximit të Kuranit (*rukja*). Po nëpërmjet tyre ai mbrohej apo kurohej nga magjia dhe syri i keq. Ai e vendoste dorën e tij mbi të sëmurin dhe thoshte: "O Zot i njerëzve! Largoje sëmundjen! Shëro, se Ti je Shëruesi! Nuk ka shërim tjetër përveç shërimit Tënd që nuk lë tjetër sëmundje".⁷⁸ Një herë, ai i tha dikujt që iu ankua se ndiente dhimbje, të vendoste dorën e tij në vendin që i dhembte dhe të thoshte: "Me emrin e Allahut", e pastaj të thoshte 7 herë "Kërkoj mbrojtje nga Allahu, që me fuqinë e Tij të më ruaj nga e keqja që më ka gjetur dhe që i ruhem".⁷⁹ Muslimi transmeton se Profeti

(a.s.) u ankua dhe atij i lexoi Xhebraili duke thënë: “Me emrin e Allahut po ta bëj këtë rukje (lexim për shërim) që të të ruajë nga çdo gjë që të lëndon, nga e keqja e çdokujt dhe nga syri i keq. Allahu të shëroftë! Me emrin e Allahut po ta bëj këtë rukje”.

- **Tersllëku:** Në doktrinën islame tersllëku dhe trishtimi nga oguret e këqija nuk ekzistojnë. Profeti (a.s.) ka thënë: “Nuk ka ... frikë nga oguri i zi”⁸⁰. Prandaj çdo besim se dita e martë dhe dita e premte janë ters apo filan orë a filan njeri sjellin tersllëk, është një besëtytni e papranueshme. Po ashtu, trishtimi nga oguri i zi, si p.sh. kur macja e zezë të pret rrugën apo kur dëgjon zërin e kukuvajkës, bën pjesë në besëtytnitë pagane dhe nuk është pjesë e besimit islam. Besëtytni të tilla janë mbeturina pagane të paasimiluara plotësisht nga besimi islam, prandaj mund t’i gjesh ato te shumë muslimanë, të cilët kujtojnë se këto paragjykime janë pjesë e fesë.

Shënime:

¹ Ngjarja transmetohet në librin *El-Musned* të imam Ahmedit, transmetimi është autentik.

² Dr. Muhamed Hamidullah, “Hyrje në Islam”, f. 228, Komuniteti Musliman i Shqipërisë, Tiranë 1993.

³ Sipas El-Buhâri dhe El-Muslim.

⁴ Sipas Ebu Daud, *Es-Sunen*, 2: 2836.

⁵ Sipas Muhamed Nasirudin Albani, *Sahîh Sunen et-Tirmidhi*, 2:1226.

⁶ Sipas El-Buhâri, *Es-sahîh*, 7:376.

⁷ Sipas Et-Tirmidhi, *Es-Sunen*.

⁸ Sipas El-Buhâri, *Es-sahîh*, 7:779.

⁹ Sipas El-Buhâri, *Es-sahîh*, 4:376.

¹⁰ Sipas El Bejhaki, *Es-Sunen*.

¹¹ Muhamad Al Ubajdli, *Rregullat e gostisë sipas Sunetit të Profetit s.a.v.s.*, f. 47, AIITC, Tiranë 2003.

¹² Sipas El-Buhâri, *Es-sahîh*, hadithi nr. 4678.

¹³ Sipas autorëve të *Es-Sunen*.

¹⁴ Sipas El-Bejhaki dhe Dârekutni.

¹⁵ Sipas El-Buhâri dhe El-Muslim.

¹⁶ Sipas El-Tirmidhi, i cili e ka konsideruar hadithin të vërtetë.

¹⁷ Sipas El-Buhâri dhe El-Muslim.

¹⁸ Sipas El-Muslim.

¹⁹ Sipas Ibn Mâxha.